

## **Përndjekja e Besimit Fetar gjatë Diktaturës Komuniste:**

### **Rasti i Don Shtjefën Kurtit**

**Msc. Gerhard Mema**

#### **BIO**

Gerhard Mema është studiues, guidë kombëtare turistike, dhe profesionist i ri në fushën e Trashëgimisë Kulturore, Historisë dhe Turizmit Kulturor. Ai ka përfunduar studimet e Ciklit Bachelor i Arteve në degën e Historisë në Universitetin Amerikan në Bullgari, Blagoevgrad dhe Masterin e Arteve në degën e Ruajtjes së Trashëgimisë dhe Menaxhimit të Siteve Kulturore në Universitetin Teknik të Brandenburgut, Kotbus, Gjermani, duke përfshirë edhe një semestër ndërkombëtar në Kajro të Egjiptit. Aktualisht punon pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në Tiranë dhe ka ndjekur kursin e kualifikimit profesional si Guidë Turistike Kombëtare te qendra NATGA. Interesat e tij përfshijnë historinë, kujtesën kolektive, trashëgiminë kulturore dhe promovimin e identitetit historik shqiptar përmes kërkimit dhe komunikimit publik.

#### **Abstrakt**

Ky studim analizon përndjekjen e Don Shtjefën Kurtit, prift katolik nga Kosova, si një rast për të kuptuar mekanizmat e kontrollit dhe represionit të policisë sekrete shqiptare. Duke e vlerësuar ushtrimin e besimeve fetare si veprim kriminal nën mbikëqyrjen operative të Sigurimit të Shtetit, rasti i Don Shtjefën Kurtit ofron një shembull domethënës për analizimin e praktikave të mbikëqyrjes, ndëshkimit dhe kontrollit shoqëror të institucionalizuar. Ky tregon se si individi, edhe përmes veprimeve të zakonshme fetare, mund të shndërrohej në një objekt të kontrollit, por njëkohësisht edhe në simbol të rezistencës.

Ky punim analizon në mënyrë konkrete se si Sigurimi e mbikëqyri, e propagandoi, e ndaloi dhe e ndëshkoi Don Shtjefën Kurtin. Metodologjikisht, studimi mbështetet në burime primare dhe dytësore, duke përfshirë dëshmitë gojore, dokumente arkivore, raportet operative të Sigurimit, aspektet e përpunimit paraprak të raporteve nga agjentët, si dhe literatura analitike dhe historiografike mbi ndalimin e besimit fetar gjatë diktaturës komuniste në Shqipëri.

Në këtë kuadër, dokumentacioni arkivor dëshmon përdorimin e gjerë të bashkëpunëtorëve, agjentëve, dhe rrjetit të informatorëve, të cilët mbikëqyrnin çdo lëvizje të priftit. Regjistroheshin komunikimet dhe takimet e tij, ndërsa shënimet operative përdorëshin për të dokumentuar aktivitetin e tij dhe për të legjitimuar masat e ndjekjes dhe izolimit. Rasti i Don Shtjefën Kurtit ndihmon studiuesit të kuptojnë se si këto burime nuk përfaqësojnë thjesht të dhëna faktike, por reflektojnë mentalitetin e një sistemi represiv ndaj besimit fetar.

Sigurimi i Shtetit përdori metoda operative të mirëorganizuar, si infiltrimin, spiunimin, presionin psikologjik, për të krijuar një atmosferë frike dhe për të izoluar dhe mbikëqyruar klerikët fetarë si Don Shtjefën Kurti. Këto praktika synonin jo vetëm ndëshkimin individual, por edhe dekurajimin e ushtrimit të besimit fetar në tërësi. Rasti në fjalë dëshmon se edhe veprimet më të zakonshme

fetare mund të interpretohen si sfidë ndaj pushtetit dhe të shërbenin si justifikim për kontrollin shtetëror.

Në përfundim, ky punim synon të kontribuojë në ruajtjen e kujtesës historike mbi persekutimin e Don Shtjefën Kurtit, duke theksuar rëndësinë e etikës në kërkimin arkivor dhe edukimin e brezave të rinj mbi pasojat e mohimit të lirisë së besimit gjatë diktaturës komuniste në Shqipëri.

*Fjalë kyçe: Sigurimi i Shtetit, përndjekja fetare, kontrolli shoqëror, mbikëqyrja operative, Don Shtjefën Kurti*